

PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE- 2019

-MBLEDHJA NR. 15-

MBI INSPEKTIMET

Në fokus të mbledhjes ishte prezantimi dhe diskutimi mbi Reformën e Inspektiveve, si një element thelbësor i reformimit të Administratës Publike dhe si një mekanizëm kyç për zbatimin në praktikë të ligjeve dhe që synon të përmirësojë përputhshmërinë me kuadrin rregullator. Bazuar në analizën e sekretariatit të Këshillit të Investimeve, u konkludua se kishte një progres të moderuar të Reformës së Inspektimit shfaqur në uljen e numrit të inspektoriateve, reduktimin e numrit të ditëve të inspektimit në biznese, standardizimin e procedurave të inspektimit, prezantimin e inspektimit online, publikimin e listave të inspektorëve. Ndërkohë, u sollën në vëmendje problematika që kanë ulur ritmin e reformës kundrejt sfidave aktuale të ekonomisë shqiptare, në kuadër të integritetit në BE si edhe përballjes me konkurrencën rajonale dhe ndërkombëtare.

KI miratoi në total 13 rekomandime si më poshtë:

Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor

Rekomandim 1

Progresi i mëtejshëm i Reformës së Inspektimit, si pjesë e reformës derregullatore kërkon një moment reflektimi dhe vlerësimi të impaktit të deritanishëm, duke saktësuar sukseset dhe prioritetizuar ndërhyrjet e integruara të reformës me reformat e tjera strukturore si ajo e administratës publike dhe shërbimit civil.

Vijueshmëria e fokusit të reformës dhe angazhimi politik mbeten parakusht duke pasur parasysh kompleksitetin e thellimit të reformës në anën përmbajtësore të saj, kompleksitetin në aspektin teknik të inspektimit, përfrimin e legjislacionit me atë të BE-së, rritjen cilësore të kapaciteteve të burimeve njerëzore, forcimin dhe akreditimin e kapaciteteve teknike-laboratorike me kostot përkatëse. Mekanizmi i konsultimit me biznesin të integrohet në mënyrë të strukturuar dhe të jetë pjesë e RIA-s, për të qartësuar efektet e pritshme të ndryshimeve rregullatore për palët e ndikuara, sidomos për biznesin. Kjo duhet të jetë kusht për draft-ligjet dhe element fortë i rekomanduar edhe për aktet nënligjore.

Rekomandim 2

Konsolidimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional ka rëndësi prioritarë për suksesin e kësaj reforme, veçanërisht në drejtim të zbatimit të kërkesave rregullatore që garantojnë konkurrencë të ndershme midis operatorëve në treg dhe formalizim të sektorëve të ekonomisë.

Ky bashkëpunim merr rëndësi të veçantë edhe në kuadrin e luftës ndaj informalitetit ku roli i funksioneve inspektuese si DPD, DPT, IshPSHSh, AKU, ISHTI dhe ISHMT etj. ka impakt mbi funksionimin e tregut. Për këtë angazhimi i qartë institucional i ministrive të linjës (drejtorive përkatëse ekzistuese ose të reja), si përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit të zbatuar nga inspektoriatet është i domosdoshëm. Ky angazhim është pjesë e

rëndësishme e koordinimit institucional mes Ministrive, Inspektoriatit Qendror dhe Inspektoriateve Shtetërore si faktor sukcesi i reformës.

Rekomandim 3

Përgatitja e një matrice të detajuar me të gjitha funksionet inspektuese dhe mbivendosjeve si fazë fillestare e hartimit të një plani konkret me afate kohore, institucione përgjegjëse, metodologji të qartësuar në lidhje me rishikimin e kuadrit ligjor sektorial nga ana e Ministrive të Linjës, në bashkëpunim me Inspektoriatin Qendror dhe Inspektoriatet Shtetërore. Progresi i reformës në drejtim të përmirësimit të legjislacionit sektorial i shërben axhendës së integrimit në BE.

Shmangia e mbivendosjes së inspektimeve si rezultat i rishikimit të ligjeve/akteve nënligjore sektoriale dhe qartësimit të kompetencave si në nivelin e inspektoriateve shtetërore ashtu edhe atyre vendore do të sjellë rritjen e eficiencës së inspektimit drejt shkallës optimale. Ulja eventuale e numrit të inspektoriateve dhe e bashkimit të funksioneve të tyre sipas objektivit të inspektimit nuk duhet të kushtëzojë zbatimin e funksioneve monitoruese dhe rregullatore që garantojnë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të konkurrencës së drejtë midis bizneseve.

Rekomandim 4

Inventarizimi i plotë i kuadrit ligjor-rregullativ të inspektimit dhe bërja i aksesueshëm lehtësisht i tij për të gjitha grupet e interesit (biznese, shoqata, inspektorë) do të përmirësojë efikasitetin e inspektimeve si dhe forcimin e rolit rregullator/ mbikqyrës së inspektimeve duke ulur kostot e përputhshmërisë së biznesit.

Rekomandim 5

Asistencë ligjore falas dhe në distancë për subjektet e inspektimit nga ana e inspektoriateve shtetërore apo vendore nëpërmjet përgatitjes së manualeve të thjeshta për rubrika të veçanta, sipas tipologjive të inspektimit dhe karakteristikave të bizneseve

Reformimi i inspektimit ka qenë dinamik, procedurat dhe praktikat janë rishikuar dhe standartizuar, këto ndryshime ndiqen lehtë nga bizneset e mëdha, por me vështirësi nga bizneset e vogla dhe të mesme. Struktura e ekonomisë sonë dominohet nga bizneset e vogla dhe të mesme, me kapacitete të kufizuara, për të cilat ndihma dhe këshillimi është i nevojshëm. Gjithashti, asistencë ligjore në modelin e një shërbimi call-center/numër i gjelbër për subjektet e inspektimit do të lehtësonte procesin e përputhshmërisë së bizneseve me ligjet/kuadrin rregullativ

Rekomandim 6

Përmirësimi (përgatitja në ato raste që mungon) dhe përditësimi i metodologjive të riskut mbi bazën e të dhënave më të fundit të monitorimit sipas sektorëve do të rrisë eficiencën e inspektimeve dhe ulë barrën për bizneset.

Struktura e bizneseve në vend është e segmentuar me tipologji të njëjsteve të vogla tregtare apo në fushën e shërbimit. Ndërkohë kapacitetet administrative janë të kufizuara si në burime njerëzore dhe financiare. Për këtë arsye, përgatitja e bazave të të dhënave sektoriale nga çdo inspektoriat dhe identifikimi i riskut të çdo aktiviteti mbi bazën e kritereve objektive, do të mundësonin inspektime efektive dhe me shpërndarje kohore të arsyeshme. Kriteret e riskut duhet të jenë të përcaktuara në legjislacionin sektorial, ndërkohë që institucionet e administratës publike duhet të mbajnë statistika sistematike dhe të strukturuar.

Rekomandim 7

Përgatitja/përmirësimi dhe bërja publike e metodologjive të aplikuara nga inspektorët për vendosjen e masave administrative të përshtatshme dhe proporcionale, konsiderohet si një mjet për të kufizuar vendimet arbitrare dhe selektive.

Standardizimi i procedurave të inspektimit e bën të domosdoshme hartimin dhe standartizimin e metodologjive për vendosjen e masave administrative, duke përdorur parimin e proporcionalitetit në raport me dëmin ekonomik/pasojën e shkaktuar nga shkelja e kryer. *Për këtë qëllim në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Neni 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit Nr. 10433, Këshilli i Ministrave/IQ duhet të miratojë Rregulloren e Përgjithshme mbi Metodologjinë e Vendosijes së Dënimeve Administrative, ndërsa inspektoriatet shtetërore dhe vendore Metodologjitë përkatëse për dënimet administrative në fushën e tyre të inspektimit.*

Rekomandim 8

Përfundimi i listë-verifikimeve për funksionet e inspektimit të inspektoriateve në nivel vendor dhe kryerja e këtyre inspektimeve në mënyrë on-line sikurse dhe inspektimet nga inspektoriatet shtetërore.

Rekomandim 9

Rritja e numrit të inspektimeve të programuara gjatë 2019 me objektivin për të patur një raport 85% me 15% midis inspektimeve të programuara dhe atyre të paprogramuara.

Fokusi i inspektimeve duhet të jetë këshillimi dhe asistimi i biznesit për të ndihmuar përputhshmërinë e tij me standardet, dhe masat administrative duhet të konsiderohen si hallka e fundit për arritjen e qëllimeve të inspektimit.

Rekomandim 10

Unifikimi i praktikave administrative nëpërmjet publikimit të komentareve.

Në këndvështrimin e bizneseve, ekspertëve dhe grupeve të interesit të kontaktuar nga Sekretariati, unifikimi i praktikave të konsoliduara shikohet si një ndër elementët më të domosdoshëm, të cilët do të reduktonin në një masë të konsiderueshme numrin e ankimeve ndaj vendimeve të administratës dhe përmirësimin e treguesit të perceptimit të bizneseve lidhur me të. Një rol shumë të rëndësishëm në unifikim mund të luajë edhe Avokatura e Shtetit, nëpërmjet rolit të saj aktiv me interpretime për çështje ligjore me karakter përgjithësues për të gjithë administratën publike. Për këtë janë të nevojshme edhe ndryshime ligjore në Ligjin Nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”..

Rekomandim 11

Në lidhje me apelimin, sugjerohet një opsion mbi unifikimin dhe centralizimin të apelimit të Inspektoriateve në Inspektoriatin Qendror për të rritur profesionalizimin, pavarësinë dhe besimin e ankimit në Inspektoriatet Shtetërore, si edhe zhvillimin e seancave dëgjimore gjatë shqyrtimit të ankimeve administrative.

Komisionet përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve të kenë në përbërje të tyre ekspertë të fushës konkrete të inspektimit dhe përfaqësues të ISH që ka vendosur masën administrative. Modalitetet dhe procedura e ndjekura të përcaktohet me një rregullore të veçantë dhe të jetë publike në faqen e IQ dhe çdo ISH. Për këtë është e nevojshme të bëhen ndryshime në Ligjin Nr. 10433 datë 16.06.2014 “Për Inspektimin”.

Rekomandim 12

Qëndrueshmëri dhe trajnimi i stafit të inspektoriateve.

Motivimi i trupave inspektuese, testimi periodik i tyre dhe vlerësimi i performancës mbi kritere të mirëpërcaktuara. Konsolidimi i programeve të trajnimit të stafit të inspektoriateve dhe veçanërisht për

komisionet e shqyrtimit të ankimimeve në lidhje me funksionet e inspektimit dhe standardet sektoriale të kërkueshme nga ana e legjislacionit..

Rekomandim 13

Të forcohet dhe strukturohet komunikimi me biznesin në funksion të transparencës dhe përputhshmërisë me standardet sektoriale të përputhshmërisë dhe procedurat e inspektimit.

Mungesa e konsultimit paraprak me bizneset në një sërë iniciativash është bërë burim i mosmarrëveshjeve administrative të cilat janë trajtuar nga strukturat apeluese të vetë insitucioneve apo dhe Gjykata Administrative. Vlerësohet se ekzistenca e këtyre mekanizmave do të mundësonte ndërgjegjesimin e subjekteve, nxitjen e dialogut midis palëve dhe uljen e kostove për biznesin. Ndërkohë vetë operatorët ekonomikë duhet të ndërgjegjësohen për sfidat që lidhen me përmbushjen e detyrimeve dhe standardeve në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis, dhe duhet të jenë proaktiv në hartimin dhe diskutimin e legjislacionit sektorial.

Më shumë informacion mund të gjendet në:

https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2019/02/EN_TN-Mbi-Inspektimet-1.pdf

-MBLEDHJA NR. 16-

“MBI INVESTIMET DHE SIGURINË JURIDIKE TË PRONËS”

Në kuadrin e analizës për stimulimin e investimeve në vend, mungesa e sigurisë juridike mbi pronën ka prekur zhvillimin e sektorit të bujqësisë për shkak të fragmentimit të tokës, ka penalizuar sektorin e turizmit për mungesë të investimeve në shkallë të gjerë, ku disa investitorë të huaj janë detyruar të lënë projektet në mes dhe në disa raste edhe të largohen nga Shqipëria.

Ndër gjetjet kryesore ishin: i) mungesa e regjistrimit sistematik fillestar të pronave private dhe shtetërore; ii) harta pronësore të papërshtatshme dhe mbivendosje të tyre; iii) regjistri elektronik i pronësisë i papërfunduar dhe shërbime të kufizuara; iv) moskoherencë ndër vite midis proceseve kalimtare të pronësisë, përfundimit të tyre dhe regjistrimit të pronave; v) pasiguri juridike për investitorët dhe sistemin bankar nga dokumenta pronësie të paqarta/pasakta vi) informalitet në tregun e pasurive të paluajtshme edhe për shkak të mosregjistrimit të njëjësive pronësore vii) toka bujqësore në një masë të madhe e paregjistruar dhe jashtë tregut formal të pasurive të paluajtshme; viii) mungesa e regjistrimit të plotë dhe të konsoliduar të pronave si pengesë për kadastrën fiskale.

KI miratoi në total 19 rekomandime:

Për t'u përmbushur në vazhdimësi

Rekomandim 1

Një vizion bashkëkohor për një standard të ri regjistrimit “të pronës” që merr në konsideratë edhe prioritetizimin e ndërhyrjeve për investime nga ana e sektorit privat.

Të përditësohet vizioni i qeverisjes në një dokument të konsoliduar duke konsideruar se “*cila ndërhyrje e rekomanduar është prioriteti më i lartë nga pikëpamja e sektorit privat dhe cili prioritet është i mundshëm të konsiderohet nga pikëpamja e Qeverisë?*”, më konkretisht: (1) Cili është vizioni i vendimmarrjes në vitin 2019, në lidhje me opsionet për zgjidhjen e problematikave të regjistrimit të pronës në raport me stimulimin e investimeve në sektorët prioritarë (bujqësi, turizëm, burime natyrore)? Do të jetë

strategji ndërsektoriale apo strategji me vete? Cila qasje do të jetë kundrejt “kostos” apo incentivimit për zgjidhjen e elementeve të konflikteve sociale që lidhen ngushtësisht me mbivendosjen e titujve të pronësisë? Të konsiderohet zgjidhja e problematikave të pronës në koherencë me zonat prioritet zhvillimi për stimulim e investimeve (Bujqësi, Turizëm), por duke respektuar të drejtat e pronësisë. (2) Hartimi i një Plani Veprimi që specifikon aktivitetet/afatet/faturën financiare/përgjegjësitë/treguesit e monitoruar dhe ndërhyrjet në të gjitha nivelet për konsolidimin e regjistrimit të pronave dhe dixhitalizimin e tij. (3) Duke pasur parasysh se korrupsioni mbetet një nga faktorët kryesorë që pengon klimën e biznesit në vend dhe në kushtet e mungesës së një sistemi drejtësie të besueshëm, sugjerohet që reforma e pronësisë të konsiderojë masa konkrete që kufizojnë praktikat korruptive të administratës në raport me biznesin dhe anasjelltas.

Rekomandim 2

Monitorimi i progresit të reformës së pronësisë.

Ligji Nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë” parashikojnë shumë procedura, masa, aktivitete dhe afate. (Për shembull, proceset kalimtare mendohet se do të zgjasin 10 vite, përditësimi i plotë i pronave të inventarizuara dhe transferuara institucioneve/njërive vendore brenda 18 muajve), për përmbushjen e të cilave ka një interes të madh publik. Në funksion të transparencës së këtyre proceseve sugjerohet: (1) *Krijimi i instrumentave monitorues të reformës dhe të respektimit të afateve*, si p.sh. ngritja e një Komiteti Monitorues, edhe me përfaqësues nga biznesi (p.sh. sektori bankar), BSH, shoqatat e biznesit, dhe shoqëri civile për mundësuar jo vetëm transparencën e fondeve, por edhe dhënien e sugjerimeve në lidhje me përballimin e sfidave të një reforme kaq kritike për ekonominë e vendit ku shtyrja e afateve dhe e zgjidhjeve përfundimtare vetëm e degradon situatën. (2) *Publikimin e raporteve monitoruese apo minutave të mbledhjeve të komitetit, në funksion të transparencës ndaj publikut mbi statusin e proceseve kalimtare*, për të monitoruar afatet e vendosura. (3) *Krijimi i një platforme interaktive në administrimin e ASHK për të administruar të gjitha masat dhe hapat e reformës, komentet e publikut dhe të grupeve të interesit, aktet ligjore dhe nënligjore të zbatueshme në fushën e pronësisë*. Besueshmëria ndaj suksesit të reformës do të varet gjithashtu edhe nga monitorimi i performancës së saj dhe jo vetëm nga ligjet dhe rregulloret e përcaktuara në letër. Hapat e mësipërm janë njësoj thelbësorë për suksesin përfundimtar të përpjekjeve të reformës dhe do të ndihmojnë në identifikimin e dobësive dhe mungesës së progresit, duke sugjeruar përshtatjet e nevojshme kundrejt plotësimit të objektivave dhe strategjisë së reformës.

Rekomandim 3

Konsultimi publik me palët dhe grupet e interesit për projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”

Rekomandim 4

Hartimi i një liste prioritare të regjistrimit të pronës shtetërore

Si një hap i parë i seriozitetit dhe angazhimit politik ndaj reformës, sugjerohet: (1) Regjistrimi (fillestar) i plotë i pronës për institucionet shtetërore për të dërguar drejt zgjidhjes përfundimtare fillimisht probleme të regjistrimit të vetë institucioneve ku shteti është pronar dhe ku administrata punon dhe ofron shërbime publike. (2) Regjistrimi i kontratave të dhëna deri me sot me qera dhe i kontratave koncesionare të pronës shtet (bujqësi, energji, turizëm, etj.) nga pushteti qëndror në ASHK. (3) Saktësimi i një liste prioritare të pronave që janë të “pastra” nga çdo lloj barre për të mundësuar stimulimin për investime. Lidhja e kontratave koncesionare ose të qirasë për pronat

shtetërore të bëhet nga institucionet shtetërore vetëm pas regjistrimit të tyre në ASHK. (4) Transparenca publike mbi statusin e kontratave të dhëna koncension ose me qera në Bujqësi, Energji, Turizëm, duke publikuar një raport ku të pasqyrohet përveç statusit të pronës shtetërore edhe informacioni i detajuar mbi nivelin e investimeve kundrejt planit fillestar të biznesit, si edhe problematikat kryesore të investitorëve dhe shtetit. (5) Formalizimi i objekteve të peregjistruara jo-shtetërore nëpërmjet përdorimit të stimujve “të përkohshëm”, veçanërisht në turizëm apo agroturizëm si sektorë prioritarë = për shembull, një afat “6 mujor falas” që do të ndihmonte edhe buxhetin e shtetit.

Rekomandim 5

Institucionalizimi i procesit të përditësimit midis PPV dhe informacionit të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme (zonat prioritarë për investime, përfshirë dhe zonat ku shteti është pronar).

Ndërkohë, për një informim në kohë dhe të vazhdueshëm të çdo dinamike ligjore në drejtim të pronësisë dhe rolit të bashkive - të stimulohet ndërgjegjësimi i bashkive për regjistrimin e PPV dhe të çdo ndryshimi në lidhje me të.

Rekomandim 6

Projekt-ligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë” (Nenet 30 e vijues) nuk parashikon sanksione për njësitë e vetëqeverisjes/institucionet shtetërore në lidhje me përditësimin e pronave të inventarizuara/transferuara i cili duhet të përfundojë brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi, dhe më pas për regjistrimin e tyre. Sugjerohet që ligji të parashikojë një element sanksioni kundrejt tyre, që rrit garancitë për zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me këtë proces me rëndësi kombëtare.

Rekomandim 7

Bashkitë, veçanërisht bashkitë e mëdha, nuk mund të vonojnë regjistrimin e pronave të tyre me argumentin e mungesës së fondeve¹ apo pavarësisë në kuadrin e reformës së decentralizimit. Ndaj, fillimisht bashkitë që mbulojnë zonat me prioritet investimet duhet: (1) Të krijojnë një Grup Pune në lidhje me ecurinë e proceset e transferimit, inventarizimit dhe regjistrimin e plotë të pronave të tyre. Grupi i punës të raportojë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak (si organi autorizues për dhënie me qira, disponimin apo tjetërsimin e tyre). (2) Raportimi i Grupit të Punës të jetë i dokumentuar dhe publik. (3) Këshilli Bashkiak të planifikojë një zë të vecantë në buxhet lidhur me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive shtetërore nëse konsiderohet proces strategjik.

Rekomandim 8

Në kuadrin e mungesës së statistikave të plota publike për numrin apo profilin e çështjeve gjyqësore me palë investitorët dhe institucionet e shtetit në lidhje me çështje të pronësisë, pranë gjykatave kombëtare apo ndërkombëtare, dhe në funksion të një analize më të thelluar, sugjerohet iniciimi i këtij procesi, nëpërmjet një grupi pune, drejtuar p.sh. nga MSHMS në të njëjtën kohë me konsolidimin e regjistrimit fillestar të pronës.

¹ *Koment: Të ardhurat e bashkive janë rritur si pasojë e rritjes së taksës lokale e cila raportohet ndër tre faktorët kryesorë që influencojnë klimën e biznesit (anketa e KI 2018).*

Rekomandim 9

Kadastra Dixhitale për pronat shtet të jetë online dhe pa kufizim aksesit për publikun e gjerë.

Si një kërkesë e vazhdueshme e biznesit dhe e qytetarëve dhe në funksion të transparencës, kjo masë do të ishte e mirëpritur dhe në funksion të llogaridhënies kundrejt taksapaguesve.

Rekomandim 10

Unifikimi i praktikave operacionale dhe të këshillimit që jepen nga drejtoritë rajonale të kadastrës për përdoruesit e shërbimeve të kadastrës, veçanërisht për institucionet financiare.

Publikimi i urdhërave unifikues të ASHK në kohë reale në faqen zyrtare të ASHK së bashku me inventarin e ligjeve dhe akteve nënligjore sektoriale të zbatueshme për të mundësuar funksionimin e shërbimeve të kadastrës si një i vetëm.

Rekomandim 11

Progresi i kadastrës fiskale, kushtëzohet nga mungesa e regjistrimit të plotë pronave, mosverifikimi në terren nga ana e bashkive, mungesën e kapaciteteve të bashkive të vogla dhe vullnetit politik për bashkitë e mëdha, mungesa e bashkëveprimit ndërmjet institucioneve. Angazhimi politik është shprehur tashmë pasi Qeveria ka alokuar fonde buxhetore (p.sh. një drejtori në MFE si pjesë e organikës të institucionit, plotësuar me staf dhe fonde në dispozicion edhe nga donatorët), platforma është ngritur por hapat konkrete dhe koha e zbatimit të saj duhet të jenë më realiste, të rishikohen pasi varen nga ecuria e proceseve paraprake që aktualisht janë në pritje për miratim.

Rekomandim 12

Reforma në fushën e pronësisë duhet të mbështetet me masa konkrete në lidhje me:

- a) programe të vazhdueshme të edukimit të nëpunësit publik në të gjitha nivelet e ofrimit të shërbimeve kundrejt bizneseve posaçërisht mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- b) mbështetja e reformës me anë të burimeve njerëzore dhe alokimit të fondeve të domosdoshme për mbylljen e procedurave në lidhje me regjistrimin e pronave;
- c) ASHK të krijojë sisteme specifike të vlerësimit të performancës së stafit në raport me performancën vjetore të institucionit dhe të procedurave të zbatuara.

Rekomandime të anëtarëve të KI:

Rekomandim 13

Personat fizikë dhe juridikë, sikurse edhe shteti vetë të detyrohen ta regjistrojnë pronën. Për të realizuar këtë objektiv duhet të konsiderohet edhe parashikimi i sanksioneve përkatëse;

Rekomandim 14

Problematika të mbartura në vite mbi dokumentacionin e pronësisë të cilat në thelb janë detaje të vogla por që pengojnë regjistrimin përfunditar të pronave, duhet të zgjidhen sa më parë dhe të tolerohen në kuadër të reformës, për të mospenguar ecurinë e reformës.

Rekomandim 15

Miratimi sa më parë i draft-ligjit që lejon edhe për investitorët e huaj blerjen e tokës bujqësore, si një proces i rëndësishëm për stimulimin e investimeve në sektorin e bujqësisë.

Rekomandim 16

Komunikimi me zyrat e ZRPP-së është sfidë e vërtetë për sipërmarrjen, veçanërisht për sektorin e ndërtimit. Vëmendja të fokusohet jo vetëm në sportele por tek përpunuesit e dosjeve, të bëhet riqarkullimi i stafit dhe trajnim sa më parë në lidhje me procedurat e regjistrimit, pasi nuk mjafton vetëm komunikimi.

Rekomandim 17

Zhblokimi i pronave të bllokuara me anë të kontratave pa afat të lidhura midis investitorëve dhe ndërtuesve.

Rekomandim 18

Duhet bërë regjistrimi i pronësisë të pronave shtetërore sipas një liste prioritare brenda një sektori nisur nga interesi i investitorëve. Për shembull, Ministria e Financave apo Ministria e Industrisë kanë prona industriale (troje ose objekte), por nuk ka pse fillohet me një pronë që është shumë larg. Bazuar në kërkesat e investitorëve, nevojitet të fillohet me prona në zona të afërta. Investitorët kërkojnë prona në qytete të mëdha të cilat janë mbi 5 ha. Ky mund të jetë një kriter gjatë fazës kur fillohet me prioritizimin e pronave të një ministrie apo të një bashkie. Kurse për bujqësinë, kërkesat e investitorëve janë për troje mbi 100 ha. AIDA mund të ofrojë ndihmë për ministrinë apo bashkitë me atë pjesë që ka të bëjë me kërkesën direkte të investitorit kur të vendosen prioritetet.

Rekomandim 19

AIDA rekomandon që pavarësisht zgjidhjes së problematikave dhe krijimit të një liste të pronave shtetërore “të pastra”, gjë e cila mund të hajë shumë kohë, për pronat që janë të pastra, duhet filluar me krijimin e pasaportës së pronës. Që do të thotë: një hartë e saktë me disa të dhëna bazë sic janë rrjeti elektrik, ujësjellësi, apo distancat nga porti e nga kufijtë, si dhe procedura e dhënies me qera apo enfiteozë të asaj prone (pasi lloj të ndryshme pronash kanë procedura të ndryshme për vënien në dispozicion).

Më shumë informacion mund të gjendet në:

https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2019/06/EN_Draft-Technical-Note-1.pdf

-MBLEDHJA NR. 17-

“MBI PROJEKT-LIGJIN PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”

Mbledhja u zhvillua në datë 29 Gusht 2019 dhe u kërkua specifikisht nga kryetarja e Këshillit të Investimeve znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë. Fokusi i takimit ishte konsultimi me anëtarët e KI të elementëve kryesore të projektligjit “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” bedhur për konsultim në datë 31 Korrik 2019 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Në këtë Mbledhje nuk u miratuan rekomandime konkrete nga KI por u presantuan komponentët kryesore të këtij projektligji si (1) Qëllimet e synuara të projekt-ligjit (2) Objekti i projekt-ligjit (3) Direktivat e përafruara (4) Risitë e projekt-ligjit (5) Modelet e ndjekura (6) Elementet e sistemit të ri fiskal (7) Aktet nënligjore (8) Sanksione (9) Fazat e propozuara për zbatimin gradual të tij dhe (10) Avantazhet që sjell ky projektligji. Mbi këto informacione pati debate nga anëtarët dhe sugjerime të cilat u mbajtën shënim nga hartuesit e projektligjit.

-MBLEDHJA NR. 18-

“MBI POTENCIALET E INVESTIMEVE DHE SEKTORËT PRIORITARË”

Objekti i kësaj mbledhjeje ishte stimulimi i debatit mbi opsionet e rritjes së qëndrueshme të investimeve dhe burimeve potenciale. Analiza u fokusua në dinamikat e fundit të rritjes ekonomike në vend, evidentimin e perceptimeve të sektorit privat, mbi nevojën e një tregu **ku parimet e qëndrueshmërisë në afat të gjatë nxisin rritjen dhe mundësojnë një optimum midis kapitalit të natyrës, fuqisë punëtore, social dhe financiar.**

Konkretisht, u evidentua që pavarësisht ekzistencës së dokumentave strategjikë të cilët përcaktojnë drejtimit e politikave, në praktikë fokusi nuk është gjithmonë i qëndrueshëm në kohë dhe në projektet mbështetëse. Gjithashtu vibet re mungesa e të dhënave dhe vlerësimi i impaktit të strategjive kombëtare të hartuara drejt arritjes së objektivave të synuar. Nga ana tjetër disponueshmëria dhe cilësia e fuqisë punëtore kundrejt kërkesave të tregut paraqitet si një nga sfidat më të cilat do të përballet shumë shpejt vendi. Nga konsultimet me sektorin privat, u konstatua se perceptimi i biznesit në lidhje me potencialet e rritjes së vendit ishin të lidhura kryesisht me stimulimin e sektorëve të energjisë, sektorit të agropëpunimit, turizmit dhe dixhitalizimit.

KI miratoi rekomandimet e grupuara në nivelin strategjik dhe në nivelin sektorial. Në mënyrë të përmbledhur rekomandimet e miratuara janë paraqitur si më poshtë:

Niveli Strategjik:

Rekomandim 1

Iniciimi i debatit mbi modelin ekonomik të Shqipërisë dhe sektorët më prioritarë që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm e që mund të konsiderohen si “niche unike” për vendin në 10-15 vitet që vijnë.

Shtyllat kryesore që duhet të konsiderohen:

- a) mbështetja e SME-ve të jenë fokusi kryesor i modelit dhe i politikave mbështetëse për zhvillim të qëndrueshëm,
- b) mirëadministrimi fiskal si faktor thelbësor i përmirësimit të klimës së biznesit në vend.

Rekomandim 2

Saktësimi i vizionit mbi fokusin e prioriteteve (në nivel qëndror dhe vendor). Për shembull, Vizioni “Shqipëria 2030”- ku të përcaktohen sektorët që konsiderohen si potencialet unike dhe motorët e rritjes.

- a) Konteksti specifik për vendin (transparenca dhe finalizimi i projekteve të mëdha infrastrukture/integrimi në BE); Vendet e rajonit po konsolidojnë përpjekjet në tregun rajonal/konkurrencë agresive;
- b) Qasje strategjike e tërheqjes së IHD-ve në koherencë me sektorët prioritarë dhe hartimin e një modeli ekonomik të matjes së impaktit të IHD me synim, rritjen e vlerës së shtuar në vend dhe integrimin në tregun e teknologjisë dixhitale moderne Evidentimin e mundësive të targetimit p.sh. sektorët të shërbimeve (duke qënë se problematika e pronës mbetet një pengesë thelbësore për tërheqjen e investimeve serioze).
- c) Evidentohet mungesa e të dhënave koherente dhe të agreguara, kapaciteteve njerëzore e financiare për analiza të thelluara dhe matjen e impaktit. Ndaj rekomandohet krijimi i një platforme ekspertësh, me një plan konkret veprimesh që të evidentojë të dhënat e munguara, mundësojë analiza të detajuara për impaktin e investimeve (si p.sh. opsionet e zëvendësimit apo reduktimit të importeve kryesore, opsionet e rritjes dhe diversifikimit të eksporteve, etj.), në indikatorët kryesorë ekonomike në koherencë me sektorët prioritarë.

Rekomandim 3

Konsolidimi dhe “depolitizim” i institucioneve në koherencë me sektorët prioritarë për të siguruar “memorien institucionale” dhe arritur potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm, p.sh.: AKBN, AKU, AIDA (mungesë/zgjerim kapacitetesh), MLAP (shkrirje strukture).

Rekomandim 4

Monitorim dhe transparencë i bashkërendimit të Investimeve Publike (qëndrore dhe vendore) në koherencë me kërkesat e strategjive të sektorëve prioritarë, për të mundësuar optimizim të Investimeve

Rekomandim 5

Rritja e bashkëpunimit të biznesit në nivel sektorial për të mundësuar aplikime në fonde të inovacionit dhe teknologjisë së informacionit, kërkim e zhvillim në fonde të partnerëve në zhvillim si p.sh. COSME etj.

Gjenerimin e projekteve të reja (në nivel kombëtar dhe ndër-rajonal) që ndikojnë në nxitjen e investimeve dhe rritjen e aftësisë përthithëse të fondeve nga BE, EBFIF etj

Rekomandim 6

Përgatitja dhe Publikimi i fondit të pasurive të paluajtshme shtetërore në dispozicion të investimeve (sipas Nenit 31 të Ligjit Nr.55/2015 “Për Investime Strategjike” dhe VKM Nr.1030 Datë 16.12.2015)

Niveli Sektorial:

Energji

Rekomandim 7

Plotësimi i kuadrit ligjor mbi sektorin e energjisë së rinovueshme (Miratimi i Metodologjisë së përcaktimit të cmimit të blerjes së energjisë prodhuar nga fotovoltaiKET (prodhuesit konsumatorë, sipas Udhëzimit të MIE, Nr. 33, datë 20.6.2019)

Rekomandim 8

Bërja efektive e tregut të liberalizuar të energjisë dhe Bursës së Energjisë. Investimi në rrjetin e shpërndarjes së energjisë për të përmirësuar aksesin teknik për prodhuesit vendorë të energjisë diellore dhe të erës

Rekomandim 9

Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës MiE-MFE-Biznes për të dialoguar mbi sfidat e sektorit në kohëncë me strategjinë e Energjisë 2018-2030.

Agropërpunimi

Rekomandim 10

Masa nxitëse mbi de-fragmentizimin e tokës bujqësore dhe nxitjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendas.

Rekomandim 11

Bërja transparente e a) informacionit dhe progresit mbi **politikat mbështetëse për sektorin e bujqësisë/agropërpunimit** nga donatorët dhe b) e ecurisë së investimeve të dbëna me kontrata shtet – private në sektor.

TIK -Dixhitalizim

Rekomandim 12

Fokusimi në krijimin e kushteve rregullatore për shërbime cilësore në fushën e komunikimeve elektronike (broadband/ 5G).

Rekomandim 13

Plotësimi i kuadrit rregullator dhe promovimi i FINTECH.

Rekomandim 14

Ngritja e një institucioni/platforme që të mundësojë koordinimin ndër-sektorial e të shtyjë përpara axhendën digjitale, kërkim dhe zhvillim dhe rritjen e kapaciteteve drejt sofistikimit të biznesit (psh Maqedonia e Veriut, Gjermania, Irlanda). Kjo platformë: (1) të përbëhet nga ekspertë të fushës, të adoptojë një filozofi ekosistemi ose zinxhiri vlerash (të ketë ndërveprim mes telekomunikacionit, medias, industrise IT, infrastrukturës, përdorueshmërisë) (2) të bashkëveprojë me një rrjet aktorësh: Akademi, biznes, shoqëri civile, start up, qeveri, media me fokus impaktin e digjitalizimit në Shqipëri në arsim, ekonomi, punësim, aspekte sociale etj.

Rekomandim 15

Krijimi i politikave konkrete incentivuese mbi arsimin profesional me fokus IT dhe aftësitë dixhitale.

TEDA

Rekomandim 16

Nga konsultimet direkte, rezulton se aktualisht ka interes nga aktivitete te ndryshme në sektorin e përpunimit (p.sh. sektorë si agro, gjysëm produkte të gatshme, apo edhe të teknologjive të informacionit dhe dixhitalizimit etj.) për të shfrytëzuar potencialet që ofrojnë zonat e lira ekonomike. Si rrjedhim do të rekomandimin bërjen aktive sa më parë të TEDAve për të shfrytëzuar potencialet që ato mund të ofrojnë.

Edukimi dhe Punësimi²

Rekomandim 17

Qasje sektoriale mbi përshtatjen e politikave të punësimit dhe përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore në drejtim të sektorëve prioritarë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kjo duhet bërë përmes (1)një kuadri të qartë regullator por edhe përmes vendosjes së standardeve e kriterëve për implementim, sikurse dhe përmes instrumentave incentivuese. (2) Krijimi i një formati (platforme) bashkëpunimi sistematik mes shkollave dhe bizneseve me qëllim që të krijohen konsorciume me aktorë bizneset-ofruesit e shërbimeve profesionale-shoqëri civile, zyra pune, zyra karriere etj. që operojnë në sektorët prioritarë.

Rekomandim 18

Qeveria të mundësojë dhënien me qera të godinave shtetërore në suport të krijimit të qëndrave të trajnimit për ridimensionimin e aftësisë të fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e tregut.

Rekomandime nga anëtarët e KI:

Rekomandim 19

Tërheqja e investitorëve të huaj në vend duhet të fokusohet në bizneset e mesme, të cilat zakonisht kanë prirjen të kthehen në viktimat e para të korrupsionit nga ana e administratës. Bizneset mikro duhen ndihmuar që të mos mbeten thjesht një biznes familjar - ky është hapi i parë i aksesit në financim

Rekomandim 20

Incentivat që duhet t'i jepen bujqësisë duhet të jenë në drejtim të formalizimit të ti

Rekomandim 21

Përzgjedhja e farave për mbjellje duhet të jetë një nga prioritetet e shtetit dhe kjo duhet të bëhet në formë të kontrolluar. Ministria e Bujqësisë duhet të punojë me fermerët shqiptarë për t'i ofruar rekomandime të duhura sipas nevojave të tregut. Gjithashtu, ka interes për përfshirje në sektorin e agro-turizmit duke shfrytëzuar lëndët e para të vendit. Kjo është e mundur të arrihet nëse shteti krijon incentiva për ta nxitur këtë.

Rekomandim 22

Në kuadër të diplomacisë ekonomike, DHTI TR propozon ndërmarrjen e tre aksioneve konkrete: i) krijimin e një modeli të ri dinamik komunikimi me tregues të matshëm (p.sh. mungon një studim mbi numrin e investitorëve të huaj që kanë ardhur në Shqipëri); ii) hapjen e pavioneve për promovimin e produkteve shqiptare, ndoshta në

² Përshtatja e kurrikulave të arsimit parauniversitar, pasuniversitare dhe formimit profesional me kërkesat e sektorëve prioritarë për investime (Mbledhja e KI mbi Aftësitë Punëtore).

Industri të caktuara me anë të zbatimit të projekteve dhe lëndëve mësimore nga ambjenti i biznesit vendas. Fleksibilitet në ofrimin e dijës nga Universitetet publike nëpërmjet programeve afatshkurtra inovative në partneritet me biznesin: Akademi Biznesi (programe intensive 1-3 ditë në një fushë të caktuar si p.sh.: Konsulencë në Menaxhim dhe Operacione, Taksa, Hartime planesh biznesi, Studime fizibiliteti, etj.). Certifikatat e marra pas përfundimit me sukses të jenë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë si një vlerë e shtuar për akses në tregun e punës (Mbledhja e KI mbi Aftësitë Punëtore).

Praktikat të standardizohen dhe të bëhen pjesë e kurrikulës - projekt model biznes – fakultet – praktika mësimore. Akreditimi i Universiteteve të konsiderojë monitorimin e marrëdhënieve shtet-biznes për zbatimin efektiv të praktikave si pjesë e kurrikulave (Mbledhja e KI mbi Aftësitë Punëtore).

formën e një “info date” dedikuar Shqipërisë—këtu të përfshihet evidentimi dhe nxitja e potencialit të diasporës për investime; iii) integrimi i ekonomisë shqiptare në tregun rajonal.

Rekomandim 23

Të krijohet një bankë zhvillimi për bizneset, ndërkohë që problematikë madhore mbetet pasiguria juridike e pronës.

Rekomandim 24

Dhomat e tregtisë të përcjellin jo vetëm problematika por edhe propozime konkrete si zgjidhje e problemeve si në nivel strategjie ashtu edhe politikash e procedurash brenda një afati 3-mujor të të gjithë elementëve të përmendur.

Rekomandim 25

Dhënia e burimeve natyrore (hidrokarburet) nuk mund të jetë më e fragmentuar sikurse bërë deri më sot. Jemi në proces të një ndryshimi të thellë të ligjit të hidrokarbureve i cili në formatin aktual nuk rezulton në favor të shtetit shqiptar, si shumë ligje apo kontrata koncesionare. Kërkohe mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë financiarë dhe e zërave të fortë të fushës së biznesit

Rekomandim 26

Finalizimi i projektit për furnizimin e fermerëve me karta elektronike, realizimi i të cilave do të sillte rezultate vërtet shumë pozitive, duke sjellë njëkohësisht edhe formalizim të procesi

Rekomandim 27

Ndryshimi i formës së organizimit në sektorin e bujqësisë, është e nevojshme nxitja e sipërmarrjeve të mesme gjë e cila mundësohet përmes ndryshimit të legjislacionit aktual si p.sh. ligji për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor

Rekomandim 28

Të organizohen aktivitete promovuese për turizmin dhe të bashkëpunohet me shoqata të tjera për organizimin e një forumi të madh biznesi (në vend të forumeve të vogla që bëhen zakonisht) Përveç qeverisë, edhe shoqata & dhomat duhet të luajnë një rol për tërheqjen e investitorëve të huaj. Kompanitë e huaja, pavarësisht qëllimit të tyre primar për të fituar, duhet që njëkohësisht të ndihmojnë vendin të rritet ekonomikisht.

Rekomandim 29

Ngritja e tre grupe pune në nivel teknik për tre sektorë prioritarë me përfaqësues të çdo ministrie përkatëse (përfshirë MFE), ku diskutimi i kësaj mbledhje të përkthehet në diçka më konkrete.

Më shumë informacion mund të gjendet në:

https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2019/11/EN_Discussion-Paper-On-Investment-Potentials.pdf